

- | | |
|-------------------------------------|--------------------------------|
| 1. Mother Theresa Association | 6. Kosova Democratic Institute |
| 2. Center for Peace and Tolerance | 7. KCIC |
| 3. Center for Policies and Advocacy | 8. FOL Movement |
| 4. Syri i Vizionit | 9. Mundesia |
| 5. ATTA | 10. ACTIV |

BULETINI TREMUJOR

Nr. 1, QERSHOR - GUSHT 2013



I. TRAJNIMI I VËZHguesVE

Trajnohen vëzhguesit afatgjatë, duke u bërë vetë trajnues për vëzhguesit afatshkurtër

24-25 gusht 2013 – Janë mbajtur trajnimet për 80 vëzhguesit afatgjatë që do të angazhohen për zgjedhjet lokale 2013 dhe për trajnimin e vëzhguesve afatshkurtër (VA). Gjatë këtyre trajnimeve, vëzhguesit janë trajnuar në disa module: 1) Monitorimi i Fushatës dhe Kostos Financiare; 2) Qytetaria Aktive; dhe 3) Dita e Zgjedhjeve. Vëzhguesit do të bashkëpunojnë me kordinatorët rajonal gjatë muajit shtator për të organizuar trajnime për të gjithë vëzhguesit afatshkurtër që DnV planifikon të angazhoj në ditën e zgjedhjeve.

II. EDUKIMI I VOTUESVE

DnV edukon votuesit jashtë Kosovës

Gusht 2013 - Fushata që ka për qëllim të informoj votuesit jashtë shtetit ka filluar më 22 gusht. DnV ka vendosur 2 tavolina informuese në aeroportin e Prishtinës dhe në kalimin kufitar në Merdare, duke shpërndarë broshura për votuesit jashtë shtetit, derisa ata udhëtonin jashtë Kosovës. Fushata synon të rrisë pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhjet e nëntorit.



BULETINI TREMUJOR

Nr. 1, QERSHOR - GUSHT 2013

Nuk ka demokraci me një gjini

Korrik/gusht 2013 – Demokracia në Veprim (DnV) ka mbajtur debat publik në Prishtinë edhe në Prizren për të diskutuar përfshirjen e plotë të gruas në procesin e ardhshëm zgjedhor. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësuese nga grupi i grave deputete, anëtarë të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), subjekteve politike, grupit jo-formal të grave deputete, kryetaret e forumeve të grave të subjekteve politike, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare.



DnV publikon thirrjen për propozime për grante të vogla

Korrik/gusht 2013 - Demokracia në Veprim (DnV) planifikon që në muajt e ardhshëm të bashkëpunoj me organizatat që merren me promovimin e të drejtave të grave, për të zbatuar aktivitete për edukimin e votuesve që kanë për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së gruas në proces zgjedhor. DnV do të mbështes organizatat e grave duke ofruar 7 mikro-grante në rajone të ndryshme të Kosovës. Së paku një nga organizatat e përzgjedhura do t'i takoj një komuniteti pakicë. Organizatat i kanë dorëzuar një numër të konsiderueshëm të aplikacioneve. Një grup punues nga anëtarët e DnV dhe sekretariatit do të shqyrtojnë projekt propozimet dhe të bëjnë përzgjedhjen e tyre gjatë ditëve në vijim.

DnV vëzhgon zgjedhjet parlamentare në Shqipëri

16 korrik 2013 - Demokracia në Veprim (DnV) ka organizuar tryezën me temën “Zgjedhjet në Shqipëri – Çka mund të mësojë Kosova”, ku morrën pjesë përfaqësues të subjekteve politike, shoqërisë civile, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe organizatave ndërkombëtare. Me përkrahjen e OSBE-së, DnV kishte dërguar 8 vëzhgues afatshkurtër në zgjedhjet parlamentare të 23 Qershorit në Shqipëri, të cilët kanë monitoruar procesin e votimit dhe të numërimit të votive.



DnV në media:

- Shqipe Pantina, Anëtare e DnV, ka diskutuar për reformën zgjedhore në RTV 21.
- Petrit Zogaj, Anëtarë i DnV, ka diskutuar për formatin e fletëvotimit në INFO Magazinë, ftuar nga Klan Kosova.
- Dardan Berisha, Kordinator i DnV, ka diskutuar për zgjedhjet lokale në Interaktiv, ftuar nga KTV.
- Ismet Kryeziu, Udhëheqës i DnV, ka diskutuar për zgjedhjet lokale në emisionin Debat, ftuar nga RTK.
- Valmir Ismaili, ka diskutuar për përgatitjet e KQZ dhe certifikimin e subjekteve politike, në lajmet kryesore në KTV.
- Shqipe Gjocaj, ka publikuar një editorial në Kohën Ditore për përfshirjen e grave në zgjedhje.

BULETINI TREMUJOR

Nr. 1, QERSHOR - GUSHT 2013

Takimet e bordit të DnV

Qershor/gusht 2013 – Bordi i Anëtarëve të Demokracisë në Veprim është takuar disa herë gjatë periudhës Qershor-Gusht 2013, dhe ka marrë vendime të rëndësishme në lidhje me vëzhgimin e zgjedhjeve lokale 2013. Ndër të tjerash, Bordi i DnV ka vendosur që:

- të jetë sa më gjithëpërfshirëse në procesin e monitorimit të zgjedhjeve duke arritur partneritet me organizata të ndryshme;
- të zhvilloj dhe miratoj strategjinë për angazhimin e DnV në situatën parazgjedhore, situatën zgjedhore dhe situatën pas-zgjedhore.
- ka përcaktuar standardet dhe kualifikimet e nevojshme për regrutimin e vëzhguesve të DnV-së;
- ka dizajnuar strategjinë për komunikim me media dhe publikun



Fuqizimi i rrjetit të organizatave

Qershor/gusht 2013 – Demokracia në Veprim ka mbajtur takime me partnerët rajonal në të gjitha rajonet e Kosovës, në mënyrë që të mobilizoj organizatat lokale, mediat dhe shoqatat e grave që të bëhen pjesë e Demokracisë në Veprim, që ta japin kontributin e tyre në monitorimin e zgjedhjeve lokale të 3 nëntorit 2013.

DnV ka arritur që të nënshkruaj marrëveshje mirëkuptimi me organizata të ndryshme të Kosovës, të cilat do të angazhohen gjatë procesit zgjedhor. DnV është e hapur për të gjitha organizatat që mund të kontribuojnë në këtë proces.



Ngjarjet në muajin e ardhshëm - Shtator 2013

- Trajnimet për vëzhguesit afatshkurtër;
- Lansimi i TV klipëve në gjuhën shqipe dhe serbe;
- 7 debate publike në komuna të ndryshme të Kosovës;
- 10 simulime të zgjedhjeve për votuesit e rinj;
- Debat dhe broshura për votuesit me nevoja të veçanta;
- Shtypi i 50.000 paketave te sheqerit.